

UDHËZUES I DETAJUAR
PËR FËMIJË PËR
RRJETET SOCIALE

Autorët

Teuta Zymeri
Tringë Sokoli
nga Qendra për studime të avancuara FIT

Mbështetur nga:

Save the Children
Programi i implementimit dhe programi për zhvillim dhe kualitet

Lektor:

Envinion

Dizajni, faqosja dhe shtypja:

Envinion

Botuar nga:

Save the Children
Gazmend Zajmi, nr. 01
10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0) 38 23 26 91
Faks: +381 (0) 38 23 26 93
scik@savethechildren.org
http://Kosovo.savethechildren.net

© Nëntor 2015 "Save the Children"

Ky publikim është i mbrojtur nga e drejta e autorit. Ai mund të riprodhohet me çdo metodë, pa pagesë apo leje paraprake për qëllime mësimore, por jo për shitje. Për përdorim në çfarëdo rrethane tjetër, leje paraprake me shkrim duhet të merret nga autori dhe botuesi. Mendimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë mendimet e Save the Children. Si pjesë e sistemit të llogaridhënies të Save the Children: nëse keni ndonjë ankesë, reagim apo pyetje, ju lutem t'i ndani ato me ne në scik@savethechildren.org.



Qendra për studime të avancuara FIT
E-mail: info@fit-ks.org
www.fit-ks.org



Save the Children

PËRMBAJTJA

HYRJA.....	4
RRJETET SOCIALE	5
FACEBOOK.....	7
Nga cilat rreziqe duhet të ruheni?	7
Rregullimi i privatësisë	7
Rregullimi i kohështrirjes dhe etiketimeve	10
INSTAGRAM.....	11
Si të raportoni përmbajtjet e papërshtatshme?	12
Si të bllokoni dikë që ju bezdisë?	12
Si të jeni të sigurt në Instagram?.....	13
SNAPCHAT.....	15
Rregullimi i privatësisë	15
Çfarë rreziku ju kanoset në Snapchat?.....	15
YouTube.....	16
Si të postoni video në YouTube?.....	17
Raportoni videot e papërshtatshme	17
KONKLUZIONE	18
REFERENCA.....	19

HYRJA

Qendra për Studime të Avancuara FIT (Qendra FIT) në partneritet me organizatën Save the Children në Kosovë ka përpiluar këtë udhëzues të detajuar për fëmijët që përdorin rrjetet sociale, në mënyrë që t'i pajisë ata me njohuri të nevojshme për të pasur një përvojë sa më të këndshme dhe të sigurt gjatë kohës që e kalojnë duke shfrytëzuar mundësitë e shumta që ofrojnë ato rrjete. Kjo nismë është realizuar në kuadër të projektit "Promovimi i përdorimit të internetit në mënyrë të përgjegjshme dhe të sigurt në mesin e fëmijëve".

Me këtë Udhëzues, kemi kënaqësinë t' u ofrojmë fëmijëve këshilla dhe udhëzime për sjelljet e tyre në rrjetet sociale. Materiali i përgatitur është në vazhdimësi të dokumenteve që ne i kemi dedikuar përdorimit të përgjegjshëm të internetit nga ana e fëmijëve në Kosovë. Qëllimi ynë kryesor është t'i vetëdijësojmë fëmijët për rreziqet potenciale të rrjeteve sociale dhe t'i përgatisim që t'i anashkalojnë ato rreziqe duke i përdorur rrjetet sociale me kujdes dhe përgjegjësi.

Gjatë përpilimit të Udhëzuesit ne kemi marrë parasysh zhvillimin e shpejtë të teknologjisë dhe jemi munduar që t'i përshtasim sa më mirë këshillat e sigurisë me rrjetet sociale më të përdorura nga fëmijët. Ngaqë synojmë që ky Udhëzues të jetë i dobishëm për të gjithë fëmijët

e interesuar, përveç hulumtimit të hollësishëm të rrjeteve sociale me përdorim të gjerë, jemi bazuar mjaft edhe në brengat dhe paraqartësitë që kanë shfaqur fëmijët, prindërit dhe arsimtarët gjatë aktiviteteve tona nëpër shkolla.

Udhëzuesi ofron informata për mundësitë e shumta që ofrojnë rrjetet sociale dhe këshilla praktike lidhur me sjelljen e fëmijëve në to. Përgjatë këtyre faqeve ofrohen shembuj konkretë dhe në formë të ilustruar për të treguar se si mund të zgjidhen problemet në situata të ndryshme në mënyrë që përdorimi i rrjeteve sociale të bëhet sa më i lehtë dhe të përshtatet me nevojat e dëshirave të fëmijëve gjatë kohës që e kalojnë në internet.

Objektivat kryesorë të këtij Udhëzuesi janë: informimi i fëmijëve me mënyrën e duhur të përdorimit të rrjeteve sociale; shpjegimi i rreziqeve potenciale që fëmijët hasin gjatë përdorimit të rrjeteve sociale; dhe ofrimi i këshillave praktike ashtu që të mos ndodhë përdorimi i pakujdesshëm i rrjeteve sociale, i cili mund të shpie në pasoja të padëshiruara.

Ne inkurajojmë të gjithë fëmijët që i shfrytëzojnë rrjetet sociale në rutinën e tyre ditore që të përdorin këtë Udhëzues i cili u ndihmon t'i identifikojnë dhe t'i shmangin rreziqet që mund t'u kanosen.

RRJETET SOCIALE

Webfaqet interaktive, lojërat, dhe në veçanti rrjetet sociale tashmë janë bërë pjesë e përditshmërisë dhe zënë një pjesë të madhe të kohës për shumë njerëz, duke përfshirë edhe fëmijët. Përdorimi i internetit ka potencial të madh për zhvillimin dhe fuqizimin e fëmijëve dhe të rinjve, si dhe për t'i ndihmuar ata në përmbushjen e nevojave të tyre për informim dhe komunikim me shoqëri.

Efektet pozitive të rrjeteve sociale veçse dihen, por fëmijët duhet të vetëdijësohen edhe për rreziqet ndaj të cilave janë të ekspozuar kur përdorin rrjetet sociale. Për të qenë në gjendje që fëmijët të shfrytëzojnë rrjetet sociale në të mirën e tyre, ata duhet të mësojnë disa rregulla të nevojshme për të qenë të mbrojtur online.

SI TË MBROHENI NË RRJETET SOCIALE?

Përdorni parametrat e sigurisë. Duke marrë parasysh sa lehtë shpërndahen informatat në internet, përdorimi i parametrave të sigurisë është i dobishëm nëse nuk doni që të gjithë t'i përcjellin gjërat që i bëni. Gjithnjë kontrolloni informacionet që i bëni publike. Poashtu, mos përtëni t'i kontrolloni herë pas here parametrat e sigurisë në rrjetet sociale që përdorni sepse ato ndryshojnë shpesh.

Raportoni sjelljet e dëmshme. Rrjetet sociale kanë rregullat e tyre njësoj si shkolla që vendos rregulla për të siguruar mbarëvajtjen e gjithçkaje. Nëse e shihni dikë që i then rregullat e përdorimit dhe ju pengon juve kur i përdorni rrjetet sociale, ju mund t'i raportoni dhe është mirë ta bëni këtë gjë. Sjelljet e personave që ju shqetësojnë nëpër rrjetet sociale dhe përmbajtjet që nuk janë të përshtatshme për moshën që e keni duhet të hiqen që të mos i shihni më.

Kujdes se çfarë postoni. Kur postoni diçka në internet, vështirë se mund ta ktheni mbrapsht. Gati çdo gjë që thoni dhe secila fotografi që e postoni mund të kopjohet, të ndryshohet dhe të shpërndahet nga të tjerët. Prandaj, mos postoni çdo gjë që ju bie ndërmend sepse ato fotografi mund të përdoren kundër jush në të ardhmen.

Respektoni të tjerët. Vetëm sepse mund të ndiheni anonim në internet, s' do të thotë se vërtetë jeni. Si në jetën reale, ashtu edhe në atë virtuale veprimet e juaja kanë pasoja, prandaj respektoni njerëzit tjerë që janë pjesë e rrjeteve sociale.

CILAT RRJETE SOCIALE JANË MË NË TREND?

Në bazë të hulumtimit “Siguria e fëmijëve në Internet”, realizuar më 2014 nga Qendra FIT, rrjeti social Facebook kryeson për nga përdorimi te fëmijët.¹ Kohët e fundit janë shumë të popullarizuara edhe Instagram, Snapchat dhe Youtube. Në rrjete sociale ata kanë mundësi edhe të postojnë fotografi, video, të luajnë lojëra, dhe të bëjnë shumë aktivitete të tjera.

Në hulumtimin me fëmijët e shtatë qyteteve më të mëdha të Kosovës, Qendra FIT ka gjetur se 84% e fëmijëve kanë llogari të tyre aktive në Facebook ose Twitter, prej të cilëve 32% kanë mbi 400 shokë². Për të pasur një llogari në rrjete sociale kërkohen disa të dhëna personale si: emri, mbiemri, mosha, e-mail, fotografia personale, adresa, apo numri i telefonit.

KUJDES: Në shumicën e rrjeteve sociale mosha e lejuar për hapje të llogarisë është mbi 13 vjeç.



¹ Besianë Musmurati, Teuta Zymeri, Siguria në Internet, Prishtinë, 2014, fq.21

² Besianë Musmurati, Teuta Zymeri, Siguria në Internet, Prishtinë, 2014, fq.22-23

FACEBOOK

Si rrjeti social me më së shumti përdorues, Facebook ofron më shumë mundësi. Por me më shumë mundësi vijnë edhe më shumë rreziqe. Në mesin e miliona përdoruesve të Facebookut në botë ka edhe shumë keqbërës të cilët kanë mundësi të shumta të ofrojnë të dhëna të rreme për vete, me qëllim të: keqpërdorimit të dhënave personale të fëmijëve dhe kërkesave për takime offline të cilat shpesh janë me pasoja për fëmijën.

NGA CILAT RREZIQE DUHET TË RUHENI?

1 **Sajbërdhuna apo dhuna online:** fëmijët e tjerë shpërndajnë fotografi, mesazhe dhe postime poshtëruese, tallen apo ju kërcënojnë juve në Facebook për motive të shumta. Ndoshta keni pasur raste edhe në jetën reale kur jeni ngacmuar me shokë, pra e dini sa keq jeni ndjerë kur shoqëria ju ka tallur.

2 **Krijimi i profileve të rreme:** juve mund t’ju hapen profile me informatat tuaja personale në emër të dikujt tjetër dhe pastaj të ju prishin imazhin me shpërndarje të gjërave të pahijshme.

3 **Takimi me njerëz të panjohur:** ju shtoni si shokë në Facebook njerëz të panjohur dhe shoqërimi me ta mund të paraqesë rrezik,

pasi nuk e dini se çfarë persona janë ata dhe çfarë janë në gjendje të bëjnë nëse pranoni të takoheni me ta.

4 **Shpërndarja e fotografive të papërshtatshme:** shokët tuaj shpërndajnë fotografi personale apo të juajat, të cilat janë të papërshtatshme dhe që mund t’ju dëmtojnë imazhin. Për shembull fotografi me veshje provokative të cilat pastaj shihen nga një audiencë më e gjerë dhe kanë mundësi shumë më të madhe keqpërdorimi.

5 **Editimi dhe keqpërdorimi i fotografive:** fotografitë e juaja mund të editohen me anë të programeve të ndryshme; psh. fytyra e një vajze mund të vendoset në trupin e një vajze tjetër e cila ka veshje të papërshtatshme, dhe të shpërndahet në rrjete sociale.

RREGULLIMI I PRIVATËSISË

Rrjeti Facebook ka bërë më të lehtë kërkimin e parametrave të privatësisë duke ofruar opsionin “shkurtesat e privatësisë”.



Këtu mund të rregulloni bazat e privatësisë suaj: kush mund të shohë profilin tuaj, kush mund të ju kontaktojë, kush mund të ju dërgojë kërkesa për shoqërim dhe mund të bllokoni persona të padëshiruar.

Ju duhet t'u kushtoni shumë rëndësi parametrave të privatësisë, sepse prej tyre varet se kush mund të shohë përmbajtjet që ju i postoni.

1 Zgjedhni vetëm shokët tuaj të ju lejohet të postojnë në kohështirjen tuaj - Nëse vendosni që të gjithë të mund të postojnë në kohështirjen tuaj atëherë edhe personat të cilët nuk i keni shokë në Facebook kanë mundësi të postojnë. Prandaj, tek rregullat e privatësisë klikoni tek opsioni "vetëm shokët".



2 Ju zgjedhni se kush mund të ju kontaktojë - Tek mesazhet zgjedhni "filtrim i rreptë" ku shumica e mesazheve janë të shokëve tuaj, mirëpo edhe personat të cilët nuk i keni shokë në Facebook mund të ju dërgojnë mesazhe të cilat nuk vijnë direkt në inbox por tek "mesazhe të tjera".



3 Zgjedhni se kush mund të ju dërgojë ftesa për shoqërim - Në rast se nuk dëshironi që çdokush të ju dërgojë ftesë është më mirë të zgjidhni mundësinë shokët e shokëve, kështu që vetëm personat me të cilët keni shokë të përbashkët mund të ju dërgojnë ftesë për shoqërim.



4 Bllokoni personat të cilët ju ngacmojnë - Nëse ndiheni të ngacmuar ju mund të bllokoni ata persona që të mos kenë më qasje në profilin tuaj mirëpo gjithmonë ruani mesazhet dhe postimet e atij personi, në mënyrë që prindërit dhe mësimdhënësit tuaj të jenë në dijeni dhe të kenë fakte se çfarë ka ndodhur.



Shiko më shumë rregullime ose vizito Bazat e Privatësisë

Pasi të keni klikuar, zgjedhni "kohështirja dhe etiketimet" dhe aty keni mundësinë të rregulloni se kush mund të shtojë gjëra në kohështirjen tuaj, kush mund t'i shikojë gjërat në kohështirjen tuaj, dhe si mund t'i menaxhoni etiketat që shtojnë njerëzit dhe sugjerimet tjera për etiketime.

5 Klikoni tek "Shiko më shumë rregullime" për të rregulluar etiketimet dhe kohështirjen tuaj.

Rregullimet e kohështirjes dhe të etiketimeve			
Kush mund të shtojë gjëra në kohështirjen time?	Kush mund të postojë në kohështirjen tënde?	Shokët	Ndrysho
	Rishiko postimet ku të kanë etiketuar shokët para se ato të shfaqen në kohështirjen tënde?	Kyçur	Ndrysho
Kush mund t'i shikojë gjërat në kohështirjen time?	Bëni një shikim paraprak se si e shohin njerëzit tjerë kohështirjen tuaj		Shiko si
	Kush mund t'i shikojë postimet në të cilat jeni etiketuar në kohështirjen tuaj?	Shokët	Ndrysho
	Kush mund të shikojë se çka postojnë të tjerët në kohështirjen tuaj?	Shokët	Ndrysho
Si mund t'i menaxhoj etiketat që shtojnë njerëzit dhe sugjerimet për etiketime?	Rishiko etiketat që shtojnë njerëzit në postimet e tua para se etiketat të shfaqen në Facebook?	Kyçur	Ndrysho
	When you're tagged in a post, who do you want to add to the audience if they aren't already in it?	Shokët	Ndrysho
	Kush mund t'i shikojë sugjerimet për etiketa kur ngarkohen foto që të ngjajnë ty?	Shokët	Ndrysho

RREGULLIMI I KOHËSHTRIRJES DHE ETIKETIMEVE

Vendosni që vetëm shokët tuaj të mund të postojnë në kohështrirjen tuaj. Kështu jeni më larg rrezikut të postimeve të pahijshme. Gjithashtu, mbani të kyçur rishikimin e postimeve në të cilat ju etiketojnë shokët tuaj, sepse ndokush mund të postojë fotografi që janë fyese apo që kur hapen shpërndajnë viruse. Kjo ju jep mundësi që të jeni të parët që shihni se në çfarë postimi ju kanë etiketuar shokët pastaj të zgjidhni se a dëshironi ta pranoni këtë etiketim që ta shohin shokët tuaj apo jo. Në postimet e juaja secili shok mund të etiketojë veten kështu duke u mundësuar shokëve të tij qasje në fotografitë tuaja. Megjithatë, ju

mund të rishikoni etiketat edhe duke klikuar te opsioni "kyçur".

Sa i përket publikimit të lokacionit tuaj, apo "check in" në Facebook, ju sugjerojmë që ta shmangni kurdo që është e mundur sepse nuk këshillohet që t'u tregoni të gjithë shokëve tuaj të Facebookut se ku ndodheni në një moment të caktuar. Kjo për shkak se postimi i lokacionit ua bën shumë të lehtë t'ju gjejnë atyre personave që duan t'ju ngacmojnë apo shqetësojnë.

Tek Rregullat e Facebook thuhet se "Ju duhet t'i keni të paktën 13 vjet që të përdorni Facebook".

Për të mësuar se çfarë lejohet në Facebook e çfarë jo, këtu mund të shihni rregullat e përgjithshme të këtij rrjeti social:
<https://www.facebook.com/communitystandards>.

INSTAGRAM


Instagrami është një rrjet social shumë i popullarizuar që përdoret posaçërisht për shpërndarjen e fotografive dhe videove. Shpërndarja e fotografive dhe videove është shumë atraktive për fëmijët ngaqë mundëson rregullimin e fotografive me filterë të ndryshëm. Videot mund të jenë nga 3 deri në 12 sekonda. Tek Rregullat e Instagramit thuhet se "Ju duhet t'i keni të paktën 13 vjet që të përdorni Instagramin".

- Biografia e shkurtër
- Fotografitë që keni postuar

RREGULLIMI I PRIVATËSISË

Ashtu si në Facebook, edhe në Instagram është e preferueshme që ta bëni profilin privat, ashtu që vetëm ndjekësit tuaj të mund t'i shohin postimet e juaja, e jo njerëzit e tjerë që ju nuk i njihni. Në këtë mënyrë zvogëlohet dukshëm mundësia e keqpërdorimit të informatave dhe postimeve tuaja, pasi ato nuk shihen nga çdokush. Për ta bërë profilin privat, zgjidhni butonin në anën e djathtë lart dhe pastaj tek opsioni "Private Account" lëvizni butonin në anën e djathtë.

Vetëm ndjekësit/followers mund t'i shohin postimet tuaja, pëlqimet dhe komentet



- Vetëm ndjekësit/followers mund të pëlqejnë, komentojnë apo shpërndajnë postimet tuaja
- Askush nuk mund të ju ndjekë/follow pa pëlqimin tuaj



SI TË RAPORTONI PËRMBAJTJET E PAPËRSHTATSHME?


Në rast se dëshironi të raportoni një postim të papërshtatshëm, ju mund ta bëni këtë në mënyrë anonime duke përcjellur hapat si vijon:

RAPORTIMI I NJË FOTOGRAFIE

Hapi i parë: Tek fotografia klikoni butonin me tri pika në anën e djathtë;




Hapi i dytë: Klikoni "Report Inappropriate";

Hapi i tretë: Klikoni arsyen se pse e raportoni këtë postim:



■ Nuk më pëlqen kjo fotografi. (I don't like this photo)

■ Kjo fotografi është spam. (This photo is spam or a scam)



■ Kjo fotografi i vë njerëzit në rrezik. (This photo puts people at risk)

■ Kjo fotografi nuk duhet të jetë në Instagram. (This photo shouldn't be on Instagram)

SI TË BLOKONI DIKË QË JU BEZDISË?


Në rast se dëshironi të bllokoni dikë që të mos ketë qasje në profilin tuaj, atëherë klikoni butonin me tri pika në anën e djathtë, "Block User" dhe "Yes, I'm sure". Në momentin që ju bllokoni dikë, ai person nuk mund të ketë qasje në profilin tuaj,

por mund të shohë komentet apo pëlqimet që i keni bërë një shoku të përbashkët në Instagram.

SI TË EKSPLORONI INSTAGRAMIN?

Eksplorimi i fotografive në Instagram mund të bëhet përmes faqes Eksploruese, ku mund të shihni fotografi të vendeve të botës, të ushqimeve të ndryshme, faqe të revistave dhe të tjera gjëra interesante. Poashtu, në këtë faqe mund të shihni fotografi të artistëve dhe njerëzve të famshëm që e shfrytëzojnë Instagramin për qëllime të publicitetit. Në këtë faqe nuk shfaqen fotografitë tuaja nëse e

keni rregulluar privatësinë ashtu që të mos e shohin njerëzit e tjerë që s'janë të njohurit tuaj.



SI TË JENI TË SIGURT NË INSTAGRAM?

Mbrojtja më e mirë në Instagram është rritja e vetëdijësimit dhe privatizimi i llogarisë. Me anë të privatizimit të llogarisë do të keni mundësinë të vendosni se kush mund t'ju ndjekë në Instagram dhe kush do të ketë qasje në postimet tuaja.

Për të qenë të sigurt në Instagram duhet të dini këto rregulla të privatësisë:

- mendoni për një fjalëkalim të sigurt, të cilin do të ishte e vështirë ta dinë të tjerët;
- mbajeni profilin privat ashtu që fotografitë e juaja të mos mund të shihen nga çdokush;
- vendosni duke u konsultuar me prindërit se cila fotografi mund të jetë më e përshtatshme për profil, meqenëse kjo foto mund të shihet nga çdokush edhe nëse e keni profilin privat;
- mos pranoni ndjekës/followers të cilët nuk i njihni;
- nëse jeni nën moshën 13 vjeç dhe keni llogari personale në Instagram atëherë ju duhet ta mbyllni Instagramin sepse ende nuk ju lejohet ta përdorni;

Për më shumë këshilla, informacione, dhe rregulla më të hollësishme rreth Instagramit, ju mund të klikoni në faqen:


<https://help.instagram.com/299484113584685>.

SNAPCHAT

Ky rrjet social ka sjellë risi në botën virtuale dhe të rinjtë e përdorin për të komunikuar mes vete në një mënyrë më atraktive. Aplikacioni Snapchat mund të instalohet pa pagesë në telefona të mençur dhe të përdoret për shpërndarjen e fotografive, videove, vizatimeve, si dhe për të komunikuar me shokë/shoqe. Një veçori e Snapchat është se të gjitha fotografitë dhe videot e shpërndara zhduken brenda 10 sekondave kështu u ofrohet përdoruesve të komunikojnë lirshëm pa pasoja afatgjatë.

"Ju duhet t'i keni të paktën 13 vjet që të përdorni Snapchat".


Fotografinë/ videon tuaj keni mundësi ta lejoni të shihet për 1-10 sekonda.



RREGULLIMI I PRIVATËSISË

Te parametrat e Snapchat, ju keni mundësi t'i bëni private fotografitë dhe videot të cilat i postoni në mënyrë që vetëm shokët e juaj mund t'i shohin. Poashtu, te opsioni se kush mund të ju dërgojë fotografi e keni mundësinë t'i lejoni vetëm shokët tuaj të ju shkruajnë dhe të ju dërgojnë fotografi dhe video.

Te parametrat e Snapchat, ju keni mundësi t'i bëni private fotografitë dhe videot te cilat i postoni kështu që vetëm shokët tuaj të mund të shohin çfarë postoni, e jo të gjithë përdoruesit nga mbarë bota. Njëkohësisht, nëse ndonjë herë ndiheni të ngacmuar nga një person, ju mund ta bllokoni atë duke mos e lejuar t'ju gjejë më në Snapchat.



ÇFARË RREZIKU JU KANOSËT NË SNAPCHAT?

Screenshot - Kur dërgoni një fotografi apo video, personi të cilit ia keni dërguar ka mundësi ta ruajë atë fotografi duke ia bërë "Screenshot". Prandaj,

mos mendoni se mund të dërgoni fotografi të pahijshme apo të turpshme dhe të shpëtoni pa pasoja, sepse gjithnjë gjenden mënyra për t'i përdorur kundër jush duke i bërë publike ato fotografi apo video.

Fëmijët të cilët janë më të rinj se 13 vjeç nuk kanë të drejtë të përdorin Snapchat, për këtë Snapchat ju drejton tek Snapkidz; version ky më i sigurt për fëmijë. Në Snapkidz ju mund të bëni fotografi,

video, dhe të vizatoni; të gjitha këto ruhen vetëm në pajisjet tuaja pa pasë mundësi të bëjni shokë askënd dhe t'i dërgoni fotografi askujt. Snapkidz ju mundëson të luani me fotografitë tuaja vetëm në pajisjet ku është instaluar aplikacioni.


Rregullat e përgjithshme të përdorimit për Snapchat mund t'i gjeni në këtë faqe: <https://support.snapchat.com/ca/abuse>.



YOUTUBE

Webfaqja YouTube ka përdorime të ndryshme, disa prej të cilave përfshijnë: shpërndarjen e videove të ndryshme, këngëve, filmave apo seriave të shkurtëra, dhe shumë lloje të tjera të videove. Fëmijët dhe të rinjtë kalojnë një kohë të madhe duke shikuar video nga më të ndryshmet.

Te butoni "search" ju mund të kërkoni video interesante edukative. Anash videos ju shfaqen video të tjera të cilat ju sugjerohen t'i shikoni. Mirëpo, këto video jo gjithmonë janë të sigurta.




■ Kërkimi i videos

■ Videot e rekomanduara



SI TË POSTONI VIDEO NË YOUTUBE?

Të gjithë e kanë mundësinë të postojnë në YouTube video nga më të ndryshmet. Postimi i videove mund të bëhet shumë lehtë, mjafton që të hapni një llogari. Publikimi i videove bëhet duke klikuar tek opsioni "Upload" dhe pastaj duke selektuar videon që dëshironi të publikohet.



Edhe në YouTube qëndron mundësia e privatizimit të videove të postuara. Në momentin e publikimit të videos, është mundësia e përzgjedhjes së privatësisë: publike - të gjithë mund të shohin videon, jo e listuar (unlisted) - video nuk del si rekomandim i listuar pa u kërkuar, private - askush nuk mund ta shohë videon përveç atyre që ju i lejoni.

Zgjedhni opsionin private që mundëson shikimin e videove vetëm nga njerëzit që i lejoni, pasi kështu zvogëlohet mundësia e përvetësimit të materialeve tuaja dhe keqpërdorimit të informatave.

RAPORTONI VIDEOET E PAPËRSHTATSHME

Kur klikoni në një video në YouTube, mund t'ju dalin video të tjera të papërshtatshme. Nëse klikoni mbi to, ndonjëherë ndodh që pamja e një videoje duket ndryshe nga ajo se çfarë përmban e gjithë videoja. Për shembull, ju jeni duke dëgjuar një këngë dhe anash saj dalin këngë të tjera të

rekomanduara; në njëren prej tyre shihet fotografia e këngëtares suaj të preferuar, por kur klikoni për ta shikuar e vëreni se ajo video nuk është këngë dhe ka përmbajtje të papërshtatshme.

Në kësi raste, ju mund të raportoni video të papërshtatshme duke klikuar tek ikona "More" poshtë videos. Pastaj, zgjedhni opsionin përse e raportoni këtë video: 1) përmbajtje seksuale, 2) përmbajtje të dhunës, 3) përmbajtje urryese, 4) akte të rrezikshme, 5) abuzim i fëmijëve, 6) spam ose me përmbajtje të rreme, 7) më cenon të drejtat.

Këtu mund të gjeni udhëzimet e përdorimit të YouTube: <http://www.youtube.com/yt/policyandsafety/communityguidelines.html>

KONKLUZIONE

Rrjetet sociale janë një mjet i mirë dhe i shpejtë për komunikim dhe shpërndarje të informacioneve, megjithatë ofrojnë rreziqe nëse nuk mësoheni t'i përdorni në të mirën tuaj. Për të pasur një përvojë sa më të këndshme dhe të sigurt në rrjetet sociale, janë disa gjëra që duhet t'i mbani në mend:

- Nëse jeni nën moshën 13 vjeçare, mos hapni llogari në rrjetet sociale deri sa të mbërrini moshën e duhur dhe pa u konsultuar me prindërit.
- Mbani llogarinë tuaj private në mënyrë që të mbroheni nga keqpërdorimi dhe përvetësimi i informatave personale.
- Mos pranoni si shokë personat që nuk i njihni dhe mos komunikoni me ta.
- Mos u dërgoni fotografi tuajat apo të të afërmeve tuaj personave që nuk i njihni.
- Shmangeni përdorimin e mundësisë për "check in" në mënyrë që të pamundësohet identifikimi i vendndodhjes tuaj nga keqberësit.

- Respektoni rregullat e mirësjelljes gjatë përdorimit të rrjeteve sociale, ashtu si do t'i respektonit rregullat në familje dhe në shkollë.
- Krijoni një kontratë me rregulla për përdorim të internetit, për të cilat do të bisedoni hapur së bashku dhe do të nënshkruhet nga të dy palët: ju dhe prindërit tuaj.
- **MOS HARRONI:** janë disa informata me ndjeshmëri të lartë, të cilat nuk duhet assesi t'i shpërndani kur jeni online dhe veçanërisht gjatë përdorimit të rrjeteve sociale.
 - Adresa e shtëpisë;
 - Emri e shkollës;
 - Email adresa;
 - Numri i telefonit;
 - Vendi ku jeni;
 - Vendi ku planifikoni të shkoni në të ardhmen e afërt.

Nëse mbani parasysh këto këshilla dhe i ndiqni udhëzimet që i kemi përgatitur në këtë Udhëzues, do ta kaloni kohën në rrjete sociale me më pak brengë se do të keqpërdoren informatat që ju i postoni, dhe përdorimi do të jetë më i këndshëm e i sigurt.

REFERENCA

Musmurati, Besianë, Zymeri, Teuta, *Siguria e fëmijëve në internet*, Save the Children, Prishtinë, 2014

McAfee, Inc., *A parent's guide to social networking sites*, Santa Clara, CA, 2009, [webhttp://promos.mcafee.com/en-US/PDF/SocialNetworking-guide.pdf](http://promos.mcafee.com/en-US/PDF/SocialNetworking-guide.pdf)

Public Legal Education & Information Center of New Brunswick, *Child Internet Safety*, New Brunswick, 2015, web

www.legal-info-legale.nb.ca/en/uploads/file/pdfs/Safety_on_the_Internet_Parents_Guide_EN.pdf

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

004: 37-053.4/.6(036)

Zymeri, Teuta

Udhësues i detajuar për fëmijë për rrjetet sociale /
Teuta Zymeri, Tringë Sokoli. – Prishtinë : Save the
Children, 2015. – 20 f. : ilustr. ; 21 cm.

Referencat : f. 19

I.Sokoli, Tringë

ISBN 978-9951-534-37-6